VENDIM
Nr. 548, datë 28.9.2023

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 6.7.2023, PËR ÇËSHTJEN "ELGAKOTI SHPK DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË" (PËR KËRKESËN NR. 63986/10 DHE 5 KËRKESA TË TJERA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 6.7.2023, për çështjen "Elgakoti sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për kërkesat nr. 63986/10 (Elgakoti sh.p.k.), nr. 11487/11 (Carciu), nr. 48963/11 (Shkëmbi), nr. 45719/12 (Kulo), nr. 45720/12 (Brovina) dhe nr. 71642/12 (Gjata), sipas shumave të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuesve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 6.7.2023, "Elgakoti sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë", kërkesa nr. 63986/10 dhe 5 kërkesa të tjera, për secilën kërkesë.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të kërkuesve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin margjinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3%.

6. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2023.

7. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA 1. LISTA E KËRKUESVE DHE SHPËRBLIMI I DREJTË

Nr.	Numri i kërkesës	Kërkuesit	Dëmi jopasuror	Kostot dhe shpenzimet[1]

[1] Plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme mbi kostot dhe shpenzimet.

1	63986/10	Elgakoti sh.p.k.	2 500 euro	
2	11487/11	Arben Carciu	3 600 euro	250 euro
3	48963/11	Edipe Shkëmbi	4 700 euro	
4	45719/12	Harallamb Kulo zëvendësuar nga trashëgimtarët: Ermioni Kulo Anila Kulo Elina Kulo	3 600 euro	
5	45720/12	Fisnik Brovina	4 700 euro	
6	71642/12	Sotiraq Gjata	4 700 euro	